

Data: 08.02.2023

## AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Mol & co” SH.P.K.

### NENI 1

Themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar “Mol & co” sh.p.k., mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Bizneseve”, ligjin nr. 9121, date 28.7.2003, “Per Mbrojtjen e Konkurrences”, Kodin Civil dhe Kodin e Punes me ortaket themelues si vijon:

Zafar Naveed, i datëlindjes 01.01.1981, emri i babait Muhammad Sharif lindur në Sheikhpura, ne Republiken Islamike te Pakistanit dhe banues në Emirated e Bashkuara Arabe ne adresen JVC Building, 902, Street Jamal Abdul Nasir, Almajaz-2, Sharja UAE, me shtetësi Pakistaneze i identifikuar me nr. pashaporte AW9671513.

Babar Ali, i datëlindjes 01.01.1995, emri i babait Liaqat Ali lindur në Sheikhpura, ne Republiken Islamike te Pakistanit dhe banues në JVC Building, 902, Street Jamal Abdul Nasir, Almajaz-2, Sharja UAE, me shtetësi Pakistaneze i identifikuar me nr. pashaporte PD1828221.

Ali Irtaza, i datëlindjes 05.12.2001, emri i babait Amanat Ali lindur në Sheikhpura, ne Republiken Islamike te Pakistanit dhe banues në Emirated e Bashkuara Arabe ne adresen JVC Building, 902, Street Jamal Abdul Nasir, Almajaz-2, Sharja UAE, me shtetësi Pakistaneze i identifikuar me nr. pashaporte AD1979401.

Ali Haider, i datëlindjes 02.12.2002, emri i babait Abdul Hameed lindur në Sheikhpura, ne Republiken Islamike te Pakistanit dhe banues në JVC Building, 902, Street Jamal Abdul Nasir, Almajaz-2, Sharja UAE, me shtetësi Pakistaneze i identifikuar me nr. pashaporte EQ6976131.

Mudassar Ahmad, i datëlindjes 28.02.2000, emri i babait Ahmad Ali lindur në Gujranwala, ne Republiken Islamike te Pakistanit dhe banues në JVC Building, 902, Street Jamal Abdul Nasir, Almajaz-2, Sharja UAE, me shtetësi Pakistaneze i identifikuar me nr. pashaporte RJ1170151.

### SELIA E SHOQERISE

### NENI 2

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranesë në adresën: Bulevardi Bajram Curri, Pallatet Agimi, Pallati nr. 41, kat 2 ap. 1 Tirane.

Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikës se Shqiperise ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranes.

1

Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se per gjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bishet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjeter.

### **KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE**

#### **NENI 3**

Kohëzgjatja e shoqerisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit me përashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

#### **NENI 4**

Objekti i veprimtarisë së shoqerisë do të jetë:

- Shërbime "delivery", dërgesa të porosive në çdo shtëpi

### **KAPITALI I SHOQERISE**

#### **NENI 5**

Kapitali i shoqerise ka vlerën 100 lekë i cili përbëhet nga 5 kuota. Kapitali i shoqerisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi te kapitalit nepërmjet shtimit te kuotave te reja, ortakët kanë te drejtë e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë. Kapitali i shoqerisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njejtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund te zvogëlohet nen kufirin minimal qe lejon ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

### **KONTRIBUTET**

#### **NENI 6**

Kapitali i shoqerisë, zotërohet nga ortaket e shoqerisë:

Ortaku Zafar Naveed zotëron 18 % të vlerës së kapitalit e cila është e barabartë me vlerën 18 lekë;

Ortaku Babar Ali zotëron 20 % të vlerës së kapitalit e cila është e barabartë me vlerën 20 lekë.

Ortaku Ali Irtaza zotëron 21 % të vlerës së kapitalit e cila është e barabartë me vlerën 21 lekë.

Ortaku Ali Haider zotëron 20 % të vlerës së kapitalit e cila është e barabartë me vlerën 20 lekë.

Ortaku Mudassar Ahmad zotëron 21 % të vlerës së kapitalit e cila është e barabartë me vlerën 21 lekë.

Rana Mat

Ab. Maje

AB

Zafar

Ali

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

### NENI 7

1. Ortakët kanë të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjeksim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zoteron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjeter i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të janë autorizuari me prokurë (perjashtohet perfaqesimi i një ortaku nga një ortak tjeter apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuari, po që se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkresë, ose nepermjet postes elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundershtim me pikën 5 të këtij nenit, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se përgjithshme irregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime per çështjet e meposhtme dhe eshte përgjegjese per to:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;

3

- c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpérblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar;
  - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
  - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
- 10.** Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 11.** Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) Shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) Investime;
  - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.** Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
- 13.** Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se per gjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
- 14.** Asambleja per gjithshme vendos me shumice te zakonshme për cështje të tillë si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% te kuotave dhe vendimet merren me me shume se gjysmen e votave te ortakeve pjesemarres.
- 15.** Asambleja e per gjithshme vendos me shumice te kualifikuar për cështje të tillë si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët,

Rana Mat

4  
Alb Gytaza

zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve te vlefshme behet vetem nese ortaket që zoterojne me shume se 70% e kuotave jane te pranishem, votojne me shkresë apo mjete elektronike. Ne kete rast vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres.

- 16.** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në kete pikë, të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

## **ADMINISTRIMI**

### **NENI 8**

1. Shoqëria administrohet nga një ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se përgjithshme sipas parashikimit ne kete statut.

## **KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE**

### **NENI 9**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose ligji.
  3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

### **EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE**

#### **NENI 10**

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare do të jetë ortaku Mudassar Ahmad.

### **EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR**

#### **NENI 11**

1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli finansiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumice te zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

### **E DREJTA E VOTES**

#### **NENI 12**

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

### **E DREJTA PER TE KALUAR REZOLUTE**

#### **NENI 13**

Asambleja e përgjithshme mund te miratoje rezolute pa plotesuar kriteret e njoftimit ne kete statut apo ne ligji. Qe te miratohet një rezolute ne mbledhjen e asamblese se përgjithshme duhet te jene te pranishem te gjithe ortaket personalisht dhe ta votojne ate ne menyre te unifikuar.

### **ZHVILLIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 14**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, seline ligjore, objektin, mund te zmadhoje apo te zvogeloje kapitalin themeltar, mund te pranoje ose te largoje ortake.

### **MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERI**

#### **NENI 15**

Shoqeria do te perpiloje dokumentet perkatese per punesimin e personave te trete duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

### **VULA E SHOQUERISE**

#### **NENI 16**

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme me tekstin perreth saj.

### **FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK**

#### **NENI 17**

Shoqeria do te rregulloje veprimtarine e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi te nenshkrum nga ortakët themelues do te fitoje personalitet juridik ne diten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### **BILANCI DHE FITIMI**

#### **NENI 18**

- 18.1. Viti finanziar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.
- 18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti finanziar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.
- 18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.

### **FUNKSIONIMI I SHOQUERISE**

#### **NENI 19**

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoquerise pavec ketij Akti Themelimi jane te percaktuara ne Statutin e Shoquerise.

### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

#### **NENI 20**

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridike e fizike vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas legjislacionit ne fuqi.

### **DISPOZITA TE TJERA**

*Zgj*  
*AB*

*Rana M*

*Ali Ifkora*

**NENI 21**

Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopje, duke patur secila kopje fuqi te plete ligjore.

Autorizohet, Av. Erion Muka për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.


Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të Shoqerise " Mol & co " sh.p.k.

**THEMELUESIT E SHOQËRISË**  
**Mol & co Shpk**  
**Perfaqesuar nga ortaket**

Zafar Naveed



Babar Ali



Ali Irtaza



Ali Haider



Mudassar Ahmad

